



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:340737

Datë: 16.01.2025

Numri i dokumentit: 06717308

KA.nr.20/2025

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, Gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në çështjen juridike të paditësit/propozuesit të masës së sigurimit paditësit KOMUNA E PRISHTINËS, me adresë Rruga “UÇK” Nr. 2 Prishtinë, me përfaqësues të autorizuar R.G Zyrtare e Lartë Ligjore tek Paditësi, kundër të paditurës Komisioni Komunal i Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni I Autobusëve”, me kërkesëpadi për anulim të vendimit të Komisionit Komunal të Aksionarëve të datës 31.10.2024, me kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, konform nenit 13 paragrafi 7 të Ligjit nr. 08/1-015 për Gjykatën Komerciale (LGJK), jashtë seancës, më datë 16.01.2025 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Hapet konflikti i kompetencës në mes të Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Departamentit për Çështje Administrative dhe Gjykatës Themelore të Prishtinës Departamentit për Çështje Administrative, për të sqaruar kompetencë në mes të dy gjykatave lidhur me këtë çështje juridike.
- II. Për të vendosur lidhur më konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, si Gjykatë më e lartë dhe e përbashkët për të dy gjykatat.

A r s y e t i m

Me datë 29.11.2024, në Gjykatën Themelore të Prishtinës Departamentin për çështje Administrative, paditësi Komuna e Prishtinës, me adresë Rruga “UÇK” Nr. 2 Prishtinë, me

përfaqësues të autorizuar R.G Zyrtare e Lartë Ligjore tek Paditësi, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komisioni Komunal i Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Stacioni I Autobusëve”, me kërkesëpadi për anulim të vendimit të Komisionit Komunal të Aksionarëve të datës 31.10.2024, me kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, Lënda është evidentuar me nr. A-4699/24.

Me aktvendim të datës A.nr. 4699/24 të datës 10.12.2024 Gjykata Themelore të Prishtinës Departamentin për Çështje Administrative, shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore për të gjykuar këtë çështje juridike dhe pasi vendimi ka marrë formë të prerë, lënda i dërgohet Gjykatës Komerciale të Kosovës, Departamenti për Çështje Administrative, Dhomave të Shkallës së Parë.

Departamenti për Çështje Administrative pranë Gjykatës Komerciale, vlerëson se nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të gjykuar këtë çështje. Gjykata erdhi në përfundim se nuk është e kompetencës lëndore për të gjykuar këtë çështje duke mbështetur në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale që përcaktojnë se “1. Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare në procedurë administrative” lidhur me par. 5 që përcakton se: “5. Të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafin 1.12 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti për Çështje Administrative.” Gjithashtu në nenin 3 par. 1, nën par. 1.10 të Ligjit për Gjykatën Komerciale është përcaktuar përkufizimi si në vijim: “Shoqëritë Tregtare – të gjitha shoqëritë tregtare të përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare”.

Mbështetur në dispozitat e lartcekura, Departamenti për Çështje Administrative pranë Gjykatës Komerciale është kompetent për shqyrtimin e kontesteve administrative të iniciuara vetëm nga shoqëritë tregtare, kundër vendimeve përfundimtare në procedurë administrative. Në këtë çështje, konflikti administrativ nuk është iniciuar nga ndonjë shoqëri tregtare, por nga Komuna e Prishtinës si njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Kosovë statusi ligjor i të cilës rregullohet me Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale.

Poashtu. Ligjit Nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare Ligji për Shoqëritë Tregtare, (LSHT) përkufizon Komunitat si si Autoritet Publik, Neni 3 paragrafi 1.4. përcakton *Autoritet publik - do të thotë çdo autoritet ekzekutiv qeveritar, organ publik, ministri, departament, agjenci, komunë ose autoritete të tjera që ushtrojnë kompetenca ekzekutive, legjislative, rregullative, administrative ose gjyqësore në Kosovë*; Prandaj, në kuptim të LSHT-ës, Komuna nuk mund të konsiderohet Shoqëri Tregtare sepse si autoritet publik ka kompetenca ekzekutive dhe rregullative te vetëqeverisjes lokale dhe nuk ushtron aktivitet ekonomik në kuptim të LSHT-së.

Andaj bazuar në nenin 17 të Ligjit për 06/L-054 për Gjykatat, Gjykata Komerciale vlerëson se për shqyrtimin e kësaj çështje është kompetent Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Gjykata bëri shqyrtimin e kompetencës lëndore sipas detyrës zyrtare mbështetur në nenin 19 të Ligjit për Procedurën Kontestimore lidhur me nenin 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, duke vepruar sipas dispozitave ligjore të cituara më lartë dhe nenin 13 par.7 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, ku përcaktohet se *“Lidhur me konfliktin e juridiksionit në mes të Gjykatës Komerciale dhe gjykatave tjera vendos Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës”*, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KA.nr.20/2025, datë 16.01.2025

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, nuk është e lejuar ankesa.